



Buletini nr. 153-Gusht- 2016- Zyra për Informim Publik - <https://kk.rks-gov.net/malisheve/>



KOMUNA E MALISHEVËS



BULETINI

Nr. 153 – Gusht – 2016 – Zyra për Informim Publik - <https://kk.rks-gov.net/malisheve/>



PAMJE NGA NATA E DYTË E FESTIVALIT FOLKLORIK “ODA E LLAPUSHËS”
EDICIONI I TRETË



Përmbajtja:

Në Malishevë u hap panairi dy ditor i veshjeve tradicionale dhe prodhimeve vendore	4
Komuna dhe MFSK nënshkruan marrëveshje për realizimin e ushtrimit “Shqiponja5”	4
U mbajt nata e parë e festivalit folklorik “Oda e Llapushës”	5
Kryetari Begaj, takoi ekipin komunal të OSBE-së.....	6
Ansambli i Vlorës, fitues i Festivalit Folklorik “Oda e Llapushës”	7
Filloi ndërtimi i trotuarit Astrazup-Dragobil	8
Asfaltohen disa rrugë në Maxharrë dhe Pagarushë	9
GIZ-i përfundoi sanimin energjetik të shkollës në Turjakë	10
Prej të martës, fillojnë debatet për hartimin e buxhetit të Malishevës	11
EVSb-të në Malishevë, do të revitalizohen	11
KF “UV Malisheva” filloi përgatitjet për sezonin e parë futbollistik	12
Komuna filloi me debatet me qytetarë për hartimin e buxhetit komunal	13
Notuesit e KN “Besa”, të parët në “Kupa e Bifurkacionit”	14
Gjelbërimi dhe ndriçimi, prioritet për banorët e Astrazupit.....	15
Komuna zbaton penalltitë për pesë operatorë.....	16
Të rinjtë e Malishevës, formojmë grup teatral	16
Vazhdon kujdesi i shtuar për ofrimin e shërbimeve për mërgimtarët	17
Komuna e Malishevës, vazhdon me mbajtjen e dëgjimeve publike për buxhet	18
Morina: Do ta ndryshojmë pamjen e fshatit Bellanicë	19
Komuna përkrahë bujqit malishevas, me shtalla e motokultivator.....	21
KPF dha gjashtë rekomandime për mbledhjen e ardhshme të kuvendit	22
Transiti, një shkollë dhe shtrati i lumit, nevoja kryesore për Malishevën	22
Janë bërë të gjitha përgatitjet për fillimin e vitit shkollor 2016-2017	23
Të rinjtë e Malishevës, në fushatë vetëdijesimi për kujdes në vozitje	24
Filloi rregullimi i të gjitha rrugëve në Dragobil	25
Filloi shkolla rinore verore në Malishevë.....	26
Në Kleçkë, ekspozohet vetura e Komandant Kumanovës	26
KK i Malishevë, shqyrtoi raportin gjashtë mujor financiar	27
Komuna nderon humanistin Bashkim Shala	28
Më 1 shtator hapet shkolla në Gurishtë	29



KN "Besa" krenaria e Malishevës.....	30
Ambienti, bujqësia, transiti dhe shtrati i lumit, prioritet i Malishevës për vitin 2017.....	31



Në Malishevë u hap panairi dy ditor i veshjeve tradicionale dhe prodhimeve vendore

Malishevë, 1 gusht



Sot në Malishevë, u hap panairi dy ditorë i veshjeve tradicionale shqiptare dhe i prodhimeve ushqimore tradicionale, në të cilin po marrin pjesë shoqata dhe individ, të cilët merren me zejen e vjetër të trashëgimisë kulturore shqiptare, sikur edhe me ushqimet tradicionale. Ky panair mbahet në kuadër të shënimit të “Ditëve të Diasporës” dhe në Malishevë organizohet krahas festivalit folklorik “Oda e Llapushës”, që gjithashtu fillon sonte.

Panairin e ka vizituar edhe kryetari i Malishevës, Ragip Begaj, i shoqëruar nga nënkryetari Rexhep Mazreku dhe drejtorët e drejtorive. Kryetari Begaj, i ka përgëzuar të gjithë pjesëmarrësit në këtë panair, për punën që e bëjnë, në ruajtjen e trashëgimisë sonë kulturore. Po ashtu Begaj, ju uroj sukses edhe në prezantimin e sotëm në këtë panair.

Përndryshe, panairi i veshjeve tradicionale dhe i ushqimeve dhe prodhimeve vendore, është tradicional në Malishevë dhe mbahet më 1 dhe 2 gusht, në kuadër të shënimit të Ditëve të Diasporës. Panairi dhe aktivitetet e tjera, në kuadër të shënimit të Ditëve të Diasporës, organizohet nga Komuna e Malishevës, përkatësisht Dretjoria për Kulturë, Rini dhe Sport (DKRS). Me këtë rast, edhe drejtoresha e DKRS-së në Malishevë, Blerta Krasniqi, i ka uruar dhe përgëzuar të gjithë pjesëmarrësit në këtë panair, për punën e tyre, në ruajtjen dhe kultivimin e trashëgimisë sonë kulturore.

Komuna dhe MFSK nënshkruan marrëveshje për realizimin e ushtrimit “Shqiponja5”



Malishevë, 1 gusht



Komuna e Malishevës dhe Ministria e Forcës së Sigurisë së Kosovës (MFSK), sot kanë nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi, për realizimin e ushtrimit fushor të FSK-së, “SHQIPONJA 5”, territorin e Komunës së Malishevës, që pritet të realizohet në muajin tetor të këtij viti.

Sipas kësaj marrëveshje të nënshkruar mes Kryetarit të Komunës së Malishevës, Ragip Begaj dhe Sekretarit të përgjithshëm të MFSK-së, Shkelzen Sylaj, MFSK do ta shfrytëzoj territorin e Komunës së Malishevës, për operimin e njësisë të saj, gjatë realizimit të këtij ushtrimi, që mbahet në kuadër të aktiviteteve të rregullta të Forcës së Sigurisë së Kosovës.

U mbajt nata e parë e festivalit folklorik “Oda e Llapushës”

Malishevë, 2 gusht

Mbrëmë në Malishevë, është mbajtur nata e parë e festivalit folklorik “Oda e Llapushës”,



edicioni i tretë. Në këtë festival, i cili organizohet nga Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport dhe mbahet në kuadër të shënimit të Ditëve të Diasporës, po marrin pjesë rapsodë, shoqëri artistike dhe ansamble të këngëve dhe valleve nga të gjitha trojet shqiptare, nga Kosova, Shqipëria, Maqedonia dhe Lugina e Preshevës.

Festivalin e shpalli të hapur i pari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, i cili ju uroi suksese të gjithë pjesëmarrësve. “Ju i përfaqësoni ansamblet e juaja, ndërsa me pjesëmarrjen tuaj, e nderoni Malishevën. Ne krenohemi me rapsodët dhe këngëtarët tanë, si Sali e Feriz Krasniqi, Sefë Mleqani me bijtë e tij, Nexhmije Pagarusha, dhe shumë e shumë këngëtar e rapsodë, të cilët me këngët e tyre, e shkruan historinë e popullit shqiptar. Ne krenohemi edhe luftën çlirimtare për



liri. Ky ishte vend i luftës dhe i diplomacisë, ishte vendi prej ku u dëgjua zëri i parë i lirisë (Radiokosovaelirë). Ky festival, do të jetë në traditën tonë dhe do të organizohet në kuadër të ditëve të diasporës, pasi diaspora për neve është jeta vet. Ju mërgimtarë dhatë gjithçka për ta mbajtur vendin”, tha kryetari Begaj në fjalën e tij. “Mërgimtarët shkuan në tërë botën për ta mbajtur gjallë popullin dhe përpjekjet tona për liri dhe sikur dallëndyshet që kthehen në follenë e tyre, edhe ju të dashur mërgimtarë, asnjëherë nuk e harruat vendin tuaj, por gjithmonë ktheheni këtu dhe vet prezenca juaj sot këtu, do të thotë shumë për ne”, tha Begaj.

Paraprakisht, të gjitha grupet, shoqëritë dhe ansamblet pjesëmarrëse, defiluan nëpër rrugët e qytetit, ndërsa festivalin e hapi SHKA “Sali e Feriz Krasniqi” nga Malisheva dhe më pas, me pikat e tyre u prezantuan pjesëmarrësit tjerë.

Sonte, duke filluar në ora 19:00, mbahet nata e dytë, dhe më pas, shpallen edhe më të mirët e festivalit. Gjatë mbrëmjes së sotme, pritet të shfaqet edhe një dokumentar për legjendat e folklorit shqiptar Sali Krasniqi e Feriz Krasniqi.

Kryetari Begaj, takoi ekipin komunal të OSBE-së

Malishevë, 2 gusht



Kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, ka pritur sot ekipin komunal të OSBE-së në Malishevë, Yusuke Hara dhe Salih Elshanin. Takimi kishte karakter pune, ku Begaj dhe Hara, kanë biseduar për çështje të ndryshme, që lidhen me punët dhe aktivitetet e Komunës së Malishevës, aktiviteve të misionit të OSBE-së dhe aktivitetet e përbashkëta për çështje të caktuara.

Kryetari Begaj dhe zyrtari i OSBE-së, Yusuke Hara, biseduan për përgatitjet që Komuna e Malishevës, është duke i bërë në procesin e hartimit të buxhetit për vitin e ardhshëm dhe për mundësinë që edhe OSBE të jep kontributin e saj, përmes tryezave dhe formave tjera, gjatë procesit të diskutimit publik lidhur me hartimin e buxhetit.

Po ashtu në këtë takim, u diskutua edhe për procesin e përfundimit të Planit Zhvillimor Komunal (PZHK), pastaj hartimi i strategjisë komunale për transparencë, çështjet e rinisë, komuniteteve dhe çështje tjera, që lidhen me aktivitetet e komunës dhe misionit që OSBE ka në vend.



Po ashtu, në këtë takim, u vlerësua lartë edhe bashkëpunimi i ndërsjellë mes Komunës së Malishevës dhe ekipit komunal të OSBE-së në Malishevë.

Ansambli i Vlorës, fitues i Festivalit Folklorik “Oda e Llapushës”

Malishevë, 3 gusht



Mbrëmë ka përfunduar Festivali Folklorik Mbarëkombëtarë “Oda e Llapushës”, edicioni i tretë, ndërsa fitues i edicionit të sivjetmë ishte Ansambli i Qendrës Kulturore nga Vlora, të cilët me prezantimin e tyre, më të kompletuar, sipas rregullave të festivalit, ku përveç këngëve dhe teksteve, ashtu edhe me valle dhe me veshje, sipas jurisë u vlerësuan më të mirët në prezantimin e tyre. Çmimin kryesor të festivalit “Salih e Feriz Krasniqi”, drejtorit të këtij

ansambli, ja dorëzoi Kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj.

Edicioni i tretë i festivalit folklorik “Oda e Llapushës”, u karakterizua me pjesëmarrje nga të gjitha trojet shqiptare, përfshi edhe diasporën, e deri në Amerikën e largët. Po ashtu, edhe publiku ishte në masë të madhe, ku morën pjesë, përveç qytetarëve të shumtë, edhe njerëz të artit e të kulturës, e sidomos nga diaspora.

Mërgimtarët tanë, ishin pjesa më e mirë e festivalit, ku morën pjesë shumë personalitete nga vendi, por edhe nga Malisheva, që jetojnë e veprojnë në mërgim, në mesin e tyre shoqëri të ndryshme kulturore, artistike dhe atdhetare, pastaj njerëz të kulturës, siç ishte mbrëmë edhe Nazmi Telaku, këngëtar i njohur, që publiku e njih nga paraqitjet e tij në ish Radio Televizionin e Prishtinës.

Pas paraqitjes të rapsodëve dhe shoqërive artistike në natën e dytë të festivalit, derisa juria profesionale, që përbëhej nga ekspertët vendorë të fushës së folklorit, trashëgimisë dhe albanologjisë, kanë bërë përzgjedhjen e më të mirëve, është shfaqur një dokumentar për Salih e Feriz Krasniqin, ikonat e rapsodisë shqiptare, që vijnë nga Komuna e Malishevës. Pastaj, jashtë konkurrence, kanë kënduar edhe këngëtarët Zyle Krasniqi dhe Motrat Krasniqi, ndërsa shoqata “Atdheu” nga Graci i Austrisë, ka ndarë një mirënjohje të veçantë për rapsodin më të vejtër të festivalit Ali Krasniqin.



Sipas jurisë profesionale e përbërë nga prof.dr.Zymer Neziri, prof.dr.Adem Zejnullahu dhe prof.dr.Izet Duraku,, çmimin e diasporës e fitoi rapsodi Shefqet Karaçica, që jeton në SHBA. Çmimi i grupit më të kompletuar, këtë edicion ju nda ansambllit nga Librazhdi. Çmimin e publikut e mori Naxhije Bytyçi-rapsode. Çmimin e karrierës e fituan “Vëllezrit Kryeziu 2”. Çmimin “Beqir Gashi”, që ndahet për pjesëmarrësin e ri , më të mirë, ju nda Anita Krasniqi, nga ansambli i Drenasit.

Ndërsa për tri vendet e para, juria profesionale i kanë vlerësuar, SHKA “Rafsha” Drume-Hot, nga Malësia e Madhe në Mal të Zi, vendi i tretë, ndërsa vendi i dytë për Ansambllin e Këngëve dhe Valleve “Dëshmorët e kombit”-Obiliq dhe vendi i parë, që mori çmim “Salih e Feriz Krasniqi”, ju dha Ansambllit të Qendrës Kulturore të Vlorës.

Filloi ndërtimi i trotuarit Astrazup-Dragobil

Malishevë, 3 gusht



Në kuadër të rregullimit të infrastrukturës së përgjithshme në Komunën e Malishevës, e në veçanti për krijimin e kushteve më të mira dhe të sigurta për lëvizjen e qytetarëve në përgjithësi, kanë filluar punimet në ndërtimin e trotuarit, që lidhë fshatrat Astrazup dhe Dragobil, përgjatë magjistrales Prishtinë-Malishevë-Rahovec. Fillimin e punimeve e kanë parë nga afër edhe kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj dhe drejtori i urbanizmit,

Ahmet Morina.

Rruga, që lidhë këto dy fshatra, ka rëndësi të veçantë për nxënësit të cilët shkojnë në shkollën në Dragobil, e që duhet ta përshkruajnë këtë vijë të magjistrales. Drejtori Morina, tha se “ky trotuar krijon siguri për fëmijët, pasi në të kaluarën janë shkaktuar disa aksidente me fatalitet dhe qëllimi ynë është, krijimi i sigurisë për nxënësit dhe për qytetarët që detyrimisht duhet të kalojnë në këtë rrugë”.

Po ashtu drejtori Morina, ka thënë se “kjo rrugë përgjatë magjistrales, është e banuar dhe shumë e frekuentuar, nga Astrazupi, në Dragobil dhe lidhet me qytetin e Malishevës dhe synim i yni është, që trotuari të shtrohet deri në Malishevë, në vitet në vijim, pasi ka nevojë për këtë, më shumë se në çdo vend tjetër, për shkak të rrezikshmërisë që aktualisht ekziston”.



Trotuari që ka filluar të rregullohet, ka një gjatësi prej rreth 800 metra dhe lidh Astrazupin me Dragobil, deri tek hyrja e shkollës së fshatit, ndërsa në të ardhmen e afërt, pritet që të vazhdohet trotuari nga Dragobil deri në hyrje të qytetit të Malishevës, duke krijuar kështu siguri dhe krijimin e kushteve më të mira për lëvizjen e qytetarëve.

Asfaltohen disa rrugë në Maxharrë dhe Pagarushë

Malishevë, 5 gusht



Komuna e Malishevës, dje dhe sot, ka shtruar disa rrugica në fshatrat Maxharrë dhe Pagarushë. Asfaltimi i këtyre rrugëve bëhet në kuadër të rregullimit të infrastrukturës së përgjithshme në Komunën e Malishevës, e në veçanti të rregullimit të rrugëve, me qëllim rritjes së mirëqenies dhe të krijimit të kushteve për lëvizje më të lehtë të qytetarëve. Këto dy fshatra, dje i kanë vizituar edhe kryetari Ragip Begaj, drejtori i urbanizimit, Ahmet

Morina, drejtori për shëndetësi dhe mirëqenies sociale, Hajdin Berisha.

Kryetari Begaj, i ka uruar banorët për këto rrugë dhe ka thënë se “si komunë po bëjnë gjithçka që kanë mundësi buxhetore, për realizimin e projekteve kapitale, në këtë rast për rregullimin e infrastrukturës rrugore”.

Nga ana tjetër edhe banorët e kanë falënderuar kryetarin Begaj dhe komunën, për këto investime, përmes së cilave, atyre ju lehtësohet lëvizja dhe kyçja në rrugët kryesore. Njëri nga banorët e lagjes së Dukojve në Pagarushë, tha se “deri më sot kanë qenë në mëdyshje si familje, që të vazhdojnë të jetojnë në lagjen e tyre, apo të shpërngulen diku tjetër, ku qasja është më e lehtë, por nga sot, përfundimisht e kanë të zgjidhur problemin e lëvizjes, pasi jeta sot është shumë dinamike dhe qasja në rrugë, është e domosdoshme”.

Ndërsa drejtori i urbanizimit, Ahmet Morina, tha se në këto dy fshatra janë shtruar më shumë se një mijë metra rrugë, të cilat lidhen me rrugët kryesore dhe këto janë investime të komunës, në kuadër të rregullimit të infrastrukturës rrugore dhe realizimit të projekteve kapitale.



GIZ-i përfundoi sanimin energjetik të shkollës në Turjakë

Malishevë, 5 gusht



Sot, me një ceremoni zyrtare, u bë dorëzimi i objekti të sanuar energjetik të shkollës në Turjakë të Malishevës. Izolimin e objektit të shkollës në Turjakë, e ka bërë GIZ-i gjerman, në bashkëpunim me Komunën e Malishevës. Në këtë ceremoni, mori pjesë Marten Menger nga ambasada gjermane në Kosovë, James Macbeth, drejtor i zyrës së GIZ-it dhe kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj.

Përfaqësuesi i Ambasadës së Gjermanisë në Prishtinë, Marten Menger, duke folur për realizimin e këtij projekti, tha se “është rezultat mbresëlënës dhe që sjellë dy pika, e para efikasitet të energjisë, e që është orientimi i së ardhmes dhe e dyta zhvillimi i programit për arsim profesional, ku nga këto lloj projekte krijohen shkathtësi dhe aftësi profesionale”. Përfaqësuesi i Ambasadës së Gjermanisë, falënderoi edhe kryetarin Begaj, për bashkëpunimin e mirë, si dhe i uroi të gjithë për këtë projekt, e në veçanti nxënësit, të cilët do ta kenë më ngrohtë në shkollën e tyre, gjatë dimrit.

“Kjo është një punë e mirë dhe është një shkollë e mirëmbajtur, dhe unë ju falënderoj të gjithëve për punën, pasi vërtetë është bërë një punë e mirë”, tha drejtori i GIZ-it, Jamec Macbeth. Sipas tij, “e bukura e kësaj është, që kjo punë është bërë së bashku” dhe uroi që kryetari Begaj të vazhdojë me investimet në shkolla.

Ndërsa kryetari Begaj, duke marrë fjalën me këtë rast, i falënderoi të gjithë për kontributin, e në veçanti GIZ-in dhe shtetin gjerman. Më pas kryetari Begaj, foli për rëndësinë e projektit dhe të përkushtimit të komunës, për investimet në arsim. “Investimi në arsim, është prioritet i veçantë i yni, gjatë këtij mandati”, tha Begaj. Pasi i falënderoi GIZ-in dhe shtetin gjerman, kryetari Begaj, tha se “si popull e kemi të vështirë, t’iu kthejmë të mirat që i keni bërë për neve në përgjithësi, por populli shqiptar, ju është mirënjohës për jetë”.

GIZ-in, Komunën e Malishevës dhe të gjithë ata që kanë kontribuar në këtë projekt me shumë rëndësi për shkollën e tyre, i ka falënderuar drejtori i shkollës, Agron Zogaj. “Përveç ruajtjes së nxehtësisë, ky izolim që i është bërë objektit të shkollës, e ka zbukuruar edhe ambientin, pasi izolimi i tërësishëm me dru, ka bërë që shkolla, të merr pamje jashtëzakonisht të mirë”, tha drejtori Zogaj.



Shkolla në Turjakë, përmes këtij projekti të GIZ-it, është izoluar në tërësi, me dru, duke bërë që shpenzimet për ngrohje të jenë shumë më të vogla, por edhe nxehtësia brenda të jetë shumë më e mirë. Ky është një nga projektet e efikasitetit të energjisë, pasi ky lloj izolimi, siç u tha edhe nga folësit, përveç ruajtjes së ngrohtësisë, krijon edhe vende pune, pasi duhet më shumë punëtori dhe punëtorë në sigurimin e materialit për këtë lloj izolimi me dru.

Prej të martës, fillojnë debatet për hartimin e buxhetit të Malishevës

Malishevë, 8 gusht

Komuna e Malishevës, përkatësisht Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa, nga dita e nesërme (e marte), do të fillojmë me mbajtjen e debateve publike nëpër fshatra, në kuadër të hartimit të buxhetit komunal për vitin e ardhshëm, përkatësisht për hartimin e projekteve kapitale. Kështu u tha në mbledhjen e Këshillit të Drejtorëve, të drejtuar nga Kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj.

Sipas drejtorit të Drejtorisë për Ekonomi, Buxhet dhe Financa, Vesel Krasniqi, qëllimi i këtyre debateve, është marrja e kërkesave të vendbanimeve dhe futja e tyre në prioritet komunale për investimet kapitale për vitin e ardhshëm, para se këto planifikime të shkojnë në Kuvendin e Komunës për miratim të projekt buxhetit dhe listës së investimeve kapitale.

Debati i parë, do të mbahet në vendbanimin më të madh në Komunën e Malishevës, në fshatin Drenoc, duke filluar nga ora 19:00 dhe këto debate janë të hapura për qytetarë, të cilët do të paraqesin kërkesat e tyre, për planifikimin e projekteve kapitale, për vitin 2017.

Këto debate, mbahen në kuadër të procesit të shqyrtimit të Kornizës së dytë Afatmesme Buxhetore dhe këtë formë të debateve të drejtpërdrejta me qytetarë, Komuna e Malishevës, e zbaton tash e tri vite me radhë, duke i marrë prioritet drejtpërdrejtë nga qytetarët, në secilin vendbanim.

Përndryshe në mbledhjen e sotme të Këshillit të Drejtorëve, udhëheqësit e drejtorive, kanë raportuar për punët e tyre dhe kanë marrë udhëzimet nga kryetari Begaj, për zhvillimin e aktiviteteve, ashtu siç i kanë planifikuar drejtoritë.

EVSB-të në Malishevë, do të revitalizohen

Malishevë, 8 gusht

Me kërkesën e Ekipit Veprues për Siguri në Bashkësi (EVSB) në Malishevë, ky ekip pritet të revitalizohet, ose rifreskohet me anëtarë. Kështu u tha sot pas takimit, që zhvilluan me kryetarin



e Komunës së Malishevës, zyrtarët e Ministrisë së Punëve të Brendshme, përkatësisht të Divizionit të Sigurisë Publike dhe kryesuesin e EVSB-ën në Malishevë. Në këtë takim, u tha se ka nevojë të rifreskohet me anëtar të rinj EVSB në Malishevë.



Gjatë takimit, u fol për nevojën e freskimit të EVSB-së në Malishevë, nevojë të cilën e mbështeti edhe kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, dhe ofroi mbështetjen e komunës në këtë drejtim. Po ashtu, gjatë takimit, u diskutuan edhe për nevojat që ka Malisheva, për sigurinë në bashkësi, duke filluar nga ndriçimi i hapësirave publike, vëzhgimi me kamera dhe rritja e bashkëpunimit mes policisë dhe qytetarëve.

“Pavarësisht se jemi komuna më e qetë dhe më e sigurt në vend, nevoja për rritjen e sigurisë në bashkësi është e domosdoshme, në mënyrë që qytetari të jetë i sigurt në shtëpinë e tij dhe në rrethin ku jeton, prandaj rritja e bashkëpunimit qytetar-polici, është shumë e nevojshme”, tha kryetari Begaj, konstatim me të cilin u pajtuan edhe EVSB edhe zyrtarët e ministrisë.

Pas rifreskimit me anëtar të rinj të EVSB-së në Malishevë, këta anëtar do të nënshtrohen edhe një trajnimi, për rolin dhe aktivitetin e tyre që do ta kenë në kuadër të Ekipeve Vepruese për Siguri në Bashkësi.

KF “UV Malisheva” filloi përgatitjet për sezonin e parë futbollistik

Malishevë, 9 gusht

Nga dje (e hëne), Klubi i Futbollit “ Ujavara Malishevë” , i ka filluar përgatitjet për sezonin e parë të saj futbollistik. Klubi i futbollit, paraprakisht i ka përfunduar të gjitha procedurat e regjistrimit dhe pranimit në Federatën e Futbollit të Kosovës, dhe nga vjeshta e këtij viti, për herë të parë do të startoj me lojërë në kuadër të ligës e dytë të Kosovës..

Ky është një moment historik në sportin e Komunës së Malishevës, pasi deri më sot i ka munguar ekipi i futbollit të madh, edhe pse në vazhdimësi ka pasur shkollë futbollit, ndërsa talent tanë janë detyruara ti ndjekin klubet tjera, përderisa futbollistët nga Malisheva, luajnë edhe në ligat e ndryshme në Evropë.



Fillimin e stërvitjeve e kanë përcjellë edhe kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj dhe drejtoresha për Kulturë, Rini dhe Sport, Blerta Krasniqi, të cilët ju kanë uruar suksese dhe ju kanë dhënë mbështetjen e Komunës së Malishevës.

KF “UV Malishevë”, do të garoj në ligën e dytë, dhe nga formimi në këtë vit, është kompletuar me futbollist të rinj, kurse trajneri i ekipit është Skënder Ulluri. Në themelimin e klubit nuk kanë munguar as donatorët, e sidomos nga bashkatdhetarët tanë, duke veçuar këtu kontributin e jashtëzakonshëm të Afrim Bytyçit, i cili është edhe kryetar i klubit. Drejtor sportiv i klubit është Kastriot Kafexholli.

Komuna filloi me debatet me qytetarë për hartimin e buxhetit komunal

Malishevë, 10 gusht



Komuna e Malishevës, ka filluar me mbajtjen e debateve me qytetarë, në kuadër të procesit të hartimit të buxhetit komunal për vitin e ardhshëm, përkatësisht për nxjerrjen e prioriteteve për investimet kapitale. Komuna e Malishevës, në tri vitet e fundit, e ka krijuar këtë traditë të debateve me qytetarë, për hartimin e prioriteteve komunale. Për këtë qëllim, mbrëmë, është mbajtur debati parë me banorët e fshatit Drenoc, si vendbanimi më

i madh në Komunën e Malishevës.

Në këtë debat, morën pjesë, kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, drejtori për buxhet dhe financa, Vesel Krasniqi, drejtori i urbanizmit, Ahmet Morina, drejtori i shërbimeve publike, Milazim Morina dhe drejtoresha për kulturë, rini dhe sport Blerta Krasniqi.

Fillimisht kryetari Begaj, i ka njoftuar banorët e Drenocit, për qëllimin e takimit, si dhe për investimet komunale, që janë bërë deri më tani në këtë fshat, siç janë rrugët, ujësjellësi, kanalizimi, fusha sporti dhe të tjera, dhe më pas kërkoi që vet banorët ti paraqesin nevojat e tyre, në mënyrë që qeveria komunale, të ketë më të lehtë hartimin e prioriteteve për investime në vitin në vijim.



Ndërsa drejtori për buxhet dhe financa, Vesel Krasniqi, i njoftoi për procesin e hartimit të buxhetit komunal, forma e hartimit të buxhetit, hartimi i projekteve për investime kapitale, si dhe i njoftoi për buxhetin tërësi. Sipas Krasniqit, për investime kapitale për vitin 2017, komuna ka rreth katër milion euro dhe këto mjete, do të investohen, ashtu siç i paraqesin kërkesat e tyre vet banorët, si dhe përmendi edhe kriteret, që sipas Krasniqit, fshatrat dhe lagjet që janë tatimpagues më të rregullt, do të kenë përparësi në investime kapitale.

Edhe drejtori urbanizimit, Ahmet Morina, i njoftoi për projektet që janë duke u realizuar në Drenoc, ku krahas rrugëve, prioritet i këtij viti është rregullimi i tërësishëm i kanalizimeve, pasi në këtë vit do të realizohen rreth nëntë kilometra kanalizim, duke e përmbyllur ndërtimin e rrjetit të kanalizimit në këtë fshat.

Kryetar i fshatit, Kapllan Krasniqi, tha se fshati i tyre, ka nevojë për rregullimin e kanalizimi dhe disa rrugëve, dhe sipas tij komuna deri diku i ka përmbushur kërkesat e banorëve, pasi është rregulluar ujësjellësi, disa rrugë janë shtruar, por përfundimi i kanalizimit, është nevojë emergjente, dhe ky projekt është duke u realizuar, sikur edhe ndërtim i trotuareve.

Sa i përket kërkesave të banorëve, krahas kanalizimit, ata kanë nevojë edhe për rregullimin e trotuareve, pasi asfaltimi i rrugëve, ka nxjerrë nevojën e rregullimit të trotuareve. Përveç këtyre dy kërkesave, banorët e fshatit kanë kërkuar, që sipas mundësive, të ndërtohet edhe një palestër sportive, për të rinjtë sportist të fshatit. Në fund, të takimit, u vendos që kryesia e fshatit që përbëhet nga përfaqësues të të gjitha lagjeve, të hartoj me shkrim kërkesat, dhe ti sjellë në drejtorinë përkatëse në komunë.

Notuesit e KN “Besa”, të parët në “Kupa e Bifurkacionit”

Malishevë, 11 gusht



Sot në qytetin e Ferizajit, organizuar nga Klubi i Notit “Kastrioti” nga Ferizaj, në bashkëpunim me Federatën e Notit të Kosovës dhe Komunën e Ferizajit, për herë të parë janë mbajtur garat e notit “Kupa e Bifurkacionit”, ku Klubi i Notit “Besa” nga Banja, për meshkuj, bindshëm kanë dalë të parët dhe kanë fituar “Kupën e Bifurkacionit”.

Njoftimi për këtë garë është bërë publik edhe nga Komuna e Ferizajit, ndërsa rezultatin si fitues të kësaj gare, për meshkuj, nga ana e KN “Besa”, e ka konfirmuar për Zyrën për Informim, trajneri i klubit, Adrian Telaku.



Sipas ueb faqes zyrtare të Komunës së Ferizajit, në këtë garë, e cila organizohet për herë të parë, dhe që synon të jetë tradicionale, kanë marrë pjesë rreth njëqind notar nga të gjitha klubet e notit në Kosovë, ndërsa sipas trajnerit Telaku, garat sapo kanë përfunduar dhe ekipi “Besa”, për meshkuj, e ka fituar këtë kupë.

Gjelbërimi dhe ndriçimi, prioritet për banorët e Astrazupit

Malishevë, 12 gusht



Në kuadër të dëgjimeve publike dhe debateve me qytetarë, për hartimin e buxhetit komunal 2017-2019, Komuna e Malishevës, mbrëmë ka mbajtur një takim me banorët e Astrazupit, me qëllim të njoftimit për hartimin e buxhetit, marrjes së kërkesave të qytetarëve. Kjo (dëgjimet publike) bëhet me qëllim të identifikimit të nevojave dhe rritjes së transparencës në procesin e hartimit të buxhetit komunal.

Kryetari Begaj, në fillim të takimit, tha se “qëllim i yni është marrja e opinioneve dhe kërkesave të juaja, për hartimin e prioriteteve komunale, për investimet që planifikojmë ti bëjmë në vitin 2017 dhe vitet në vijim”.

Ndërsa drejtori i buxhetit, Vesel Krasniqi, tha se “kjo është mënyra më transparente për hartimin e buxhetit, ku ju qytetar njoftoheni për formën e hartimit të buxhetit dhe në të njëjtën kohë, përmes kërkesave të juaja, ne i nxjerrim e prioritetet e komunës për investimet kapitale”.

Gjatë diskutimit, banorët e fshatit Astrazup, i paraqitën disa kërkesa, ku kërkesë e parë ishte rregullimi i hapësirave të gjelbëruara brenda fshatit, pastaj ndriçimi i hapësirave dhe rrugëve, një sallë e sportit, rregullimi i shtratit të rrjedhës së ujit në fshat, si dhe rregullimi i disa rrugicave, siç është “Rruga e Mësuesit”, pastaj rregullimi i kycjes së një rruge në magjistralen që kalon në mes të fshatit, rruga afër xhamisë dhe përkujdesje ndaj një rasti social.

Por banorët e fshatit, shfaqën edhe problemin e tyre kryesorë, e që nuk ka të bëjë me buxhetin komunal, ishte problemi me gurëthyesit afër fshatit, ku sipas banorëve, nga detonimet që bëhen, në disa lagje kanë problem me qarjet e mureve të shtëpive, si dhe problem është bërë edhe ndotja e ambientit nga ana e gurëthyesve, pasi pluhuri ju bie në tërë fshatin dhe në tërë malin e fushën përreth Astrazupit.



Komuna zbaton penalltitë për pesë operatorë

Malishevë, 12 gusht

Komuna e Malishevës, përkatësisht Drejtoria e Urbanizimit, gjatë kësaj jave zbatuar të ashtuquajturat “penallti” për së paku pesë operatorë, të cilët nuk i kanë respektuar planet dinamike në kryerjen e punimeve, gjatë realizimit të projekteve. Kështu ka bërë të ditur sot drejtori i urbanizimit, Ahmet Morina, në mbledhjen e Këshillit të Drejtorëve.

Në mbledhjen e sotme të Këshillit të Drejtorëve, kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, kërkoi nga drejtoritë, që të jenë shumë aktiv në realizimin e projekteve që janë duke u realizuar gjatë këtij viti, duke kërkuar, që mos të shkaktohen vonesa në implementim e tyre.

Lidhur me këtë çështje, drejtori i urbanizimit, Ahmet Morina, ka thënë se “drejtoria e urbanizimit ka gjobitur së paku pesë operator të ndryshëm, të cilët nuk i kanë zbatuar planet dinamike, gjatë realizimit të projekteve”. Po ashtu Morina, ka paralajmëruar të gjithë operatorët, që i neglizhojnë kryerjen e punimeve, se i pret e njëjta masë, dhe nëse edhe pas këtyre “penalltive”, nuk i realizojnë ato, atëherë do të vazhdohet me masat tjera ligjore, deri në shkëputje të kontratave.

Drejtori Morina, këtë paralajmërim për zbatimin e “penalltive”, e ka bërë në fillim të marrjes së detyrës për drejtimin e Drejtorisë së Urbanizimit në Komunën e Malishevës, më 22 shkurt 2016, në mbledhjen e rregullt të Këshillit të Drejtorëve.

Të rinjtë e Malishevës, formojmë grup teatral

Malishevë, 12 gusht

Sot në Ditën Ndërkombëtare të Rinisë, është bërë një marrëveshje, mes komunës dhe kompanisë “Matrix Culture”, për formimin e grupit teatral në Malishevë dhe përgatitjen e një shfaqjeje teatrale. Formimi i grupit të aktrimit, ishte më herët edhe iniciativë e vullnetarëve të Qendrës Rinore në Malishevë, pasi aktualisht, qyteti i Malishevës, nuk disponon teatër dhe





grup të organizuar teatral.

Për këtë qëllim sot është mbajtur një takim, mes kryetarit të Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, drejtoreshës për Kulturë, Rini dhe Sport, Blerta Krasniqit, zyrtarit për rini, Mehdi Krasniqit, vullnetarëve të Qendrës Rinore dhe Marigona Bekteshit, regjisore e tetarit, përkatësisht, përfaqësuese e “Matrix Culture”, me qëllim të formimit të këtij grupi teatral.

Pasi i uroi të rinjtë për Ditën e Rinisë, Kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, e vlerësoi lartë këtë iniciativë dhe ofroi mbështetjen e Komunës së Malishevës, për formimin e këtij grupi, e gjithashtu edhe drejtoresha Krasniqi, tha se drejtorja, do të bëjë gjithçka që rinia dhe adhuruesit e teatrit, të kenë një grup të tillë, që nesër të mund të shndërrohet edhe në grup profesional.

Nga ana tjetër edhe Marigon Bekteshi, sqaroi se me këtë grup, to bëhen ushtrimet e nevojshme dhe më pas, do të përgatitet një shfaqje teatrale, dhe përmes kësaj kanë për qëllim nxitjen e të rinjve për përgatitjen e shfaqjeve teatrale, për të gjithë ata të rinj që kanë talent aktrimin.

Përndryshe, sot në kuadër të Ditës së Rinisë, në Malishevë, do të jepet një shfaqje teatrale.

Vazhdon kujdesi i shtuar për ofrimin e shërbimeve për mërgimtarët

Malishevë, 15 gusht

Që nga fillimi i sezonit të verës, është duke vazhduar kujdesi i shtuar i shërbimeve komunale, përkatësisht i zyrave të ofiqarisë dhe zyrave tjera, në ofrimin e shërbimeve për mërgimtarët tanë, dhe deri më tani nuk janë regjistruar ankesa nga ana e mërgimtarëve, për kryerjen e shërbimeve. Kështu u tha sot, në mbledhjen e rregullt të Këshillit të Drejtorëve, të cilën e drejtori nënkryetari i Komunës së Malishevës, Raxhep Mazreku, e i cili kërkoi që kujdesi i shtuar për ofrimin e shërbimeve ndaj mërgimtarëve të vazhdoj.

Drejtori i administratës së përgjithshme, Hajrullah Mazreku, tha se “përkundër fluksit mjaftë të madh të mërgimtarëve dhe qytetarëve të tjerë, për kryerjen e shërbimeve për dokumentacion, nuk ka pasur vonesa dhe nuk janë regjistruar ankesa nga ana e qytetarëve, kurse kjo gatishmëri, do të vazhdoj edhe në javët në vijim, për aq sa mërgimtarët kanë nevojë për shërbimet e komunës”.



Përndryshe në mbledhjen e sotme të Këshillit të Drejtorëve, u tha se po vazhdohet me realizimin e projekteve kapitale, në pothuajse të gjitha vendbanimet e Komunës së Malishevës, ku është duke u punuar në shkolla, rrugë, kanalizime dhe projekte tjera, sipas planifikimeve komunale. Drejtori i urbanizimit, Ahmet Morina, tha se “zbatimi i penalltive, ka dhënë efekte pozitive, qysh në ditët e para, pasi kompanitë e kanë shtuar intensitetin e punimeve, në kryerjen e dinamikës së planifikuar”.

Në këtë mbledhje, drejtori për buxhet dhe financa, Vesel Krasniqi, tha se “ka rritje në të hyrat vetanake, ndërsa drejtorja është duke vazhduar me mbajtjen e dëgjimeve publike me qytetar, direkt në vendbanime, në kuadër të procesit të hartimit të buxhetit komunal, përkatësisht qarkores së dytë buxhetore”.

Kurse, sa i përket situatës epidemiologjike, drejtori për shëndetësi, Hajdin Berisha, deklaroi se “nuk ka raste të regjistruara me EHKK, si dhe numri i thumbimeve nga rriqrat ka rënë dukshëm dhe ato janë raste sporadike”.

Komuna e Malishevës, vazhdon me mbajtjen e dëgjimeve publike për buxhet

Malishevë, 16 gusht

Komuna e Malishevës, po vazhdon me mbajtjen e dëgjimeve publike për projekt buxhetin 2017-



2019, me theks të veçantë për buxhetin e vitit të ardhshëm. Për këtë qëllim, mbrëmë, është mbajtur një takim me qytetarë në fshatin Carrallukë, ku është bashkëbiseduar për buxhetin, përkatësisht për investimet kapitale për vitin 2017 dhe nevojat që ka ky fshat i madh i Komunës së Malishevës.

Në këtë takim, morën pjesë, drejtori për buxhet, Vesel Krasniqi, drejtor i urbanizimit Ahmet Morina dhe drejtori për gjeodezi dhe kadastër, Blerim Thaçi. “Ne sot po bashkëbisedojmë për projekt buxhetin 2017-2019, dhe kjo është jo vetëm transparencë, por është planifikim i projekteve, duke u bazuar në kërkesat e qytetarëve dhe ne si qeveri komunale, jemi duke e praktikuar tash e tri vite këtë formë të hartimit të buxhetit dhe si



rezultat i kësaj, në këto tri, nuk ka fshat në Malishevë, që nuk e ka fituar, së paku një projekt brenda vitit”, tha drejtori Krasniqi.

Fillimisht, drejtori Krasniqi, i njoftoi për formën e ndarjes së buxhetit, dhe më pas i njoftoi edhe për orientimin e komunës në shpërndarjen e buxhetit, në veçanti për investimet kapitale. “Ne si qeveri komunale, nuk kemi mundësi të ndërtojmë fabrika, për krijimin e vendeve të punës, por, ne kemi zgjedhur një formë tjetër, dhe për këtë vit, jemi të përcaktuar në investime në bujqësi, si mundësia më e mirë për krijimin e vendeve të reja të punës, dhe çdo projekt që bëhet në bujqësi, përmes së cilit krijohen vende pune, ne do ta përkrahim”, tha drejtori Krasniqi.

Ndërsa, duke biseduar për nevojat e fshatit Carrallukë, kërkesë kryesore ishin asfaltimet e disa rrugëve në fshat, kryesisht rrugë brenda lagjeve. Kryetari i fshatit, Rustem Hoti, tha se “ kanë disa nevoja si fshat, por pas këtij takimi, si fshat do ta bëjnë edhe një konsultim tjetër, në mënyrë që ti përzgjedhin prioritetet e fshatit, pasi përveç rrugicave, kanë nevojë edhe ndriçim në fshat”.

Rruga në lagjen Balaj, rruga që lidh dy pjesët e fshatit, rrugicat në dy lagje tjera, riparimi i kanalizimit dhe një trotuar, ishin kërkesat që dolën gjatë takimit me banorët, por kryesia e fshatit, do të bëjë në listë të ngushtë të prioritetëve dhe do ta dorëzoj në qeverinë komunale, me qëllim të përfshirjes së kërkesave të Carrallukës, në listën e planifikimeve për investime kapitale për vitin 2017.

Karakteristikë e këtyre takime, që janë mbajtur deri më tani, ishte shprehja e kënaqësisë nga ana e qytetarëve, që qeveria komunale, po bashkëbisedon për hartimin e buxhetit, të cilën, siç e quajti Idriz Hoti nga Carralluka, është shembull i mirë i llogaridhënies dhe transparencës, por edhe vendimmarrjes së qytetarit, në këtë rast, në hartimin e prioritetëve për investime, i cili gjithashtu bëri thirrje që të paguhet tatimi në pronë nga ana e qytetarëve, e sidomos nga ata që janë të punësuar.

Morina: Do ta ndryshojmë pamjen e fshatit Bellanicë

Malishevë, 17 gusht

Mbrëmë (e marte), është mbajtur dëgjimi publik i radhës, në Bellanicë, në kuadër të procesit të hartimit të projekt buxhetit komunal 2017-2019. Në këtë takim, u tha se janë menduar disa projekte për Bellanicën, disa janë në proces e disa tjera do të jenë për vitin e ardhshëm, projekte të cilat do t’ia ndryshojnë pamjen për të mirë, këtij fshati. Rrugicat, fusha e sportit dhe ndriçimi, këto ishin planifikimet komunale dhe në të njëjtën kohë edhe kërkesa të qytetarëve.

Fillimisht, nënkryetari i Komunës së Malishevës, Rexhep Mazreku, i njoftoi të pranishmit me qëllimin e këtij takimi. “Ne si qeveri komunale po bëjmë përpjekje për realizimin e projekteve,



që kanë bënë me rritjen e mirëqenies së qytetarëve, si dhe po mundohemi të jemi sa më transparent që është e mundur, përfshi edhe hartimin e prioriteteve komunale, të cilat po i bëjmë bashkë me ju”, tha nënkryetari Mazreku, duke i ftuar banorët, që ata vet ti paraqesin nevojat që kanë si fshat.



Më pas, drejtori i urbanizimit, Ahmet Morina, i njoftoi me projektet që janë duke u realizuar dhe me ato që janë në proces e sipër, si dhe me projektet që kanë menduar ti realizojnë gjatë vitit 2017-2019, por që, siç tha Morina, nëse ju si fshat i dëshironi ato. Drejtori Morina, tha se aktualisht po punohet në rregullimin e tërësishëm të kanalizimeve, pastaj rrugicat brenda lagjeve, si dhe në proces e sipër është projekti i fushës sportive, kurse për vitin e ardhshëm, planifikohet rregullimi i ndriçimit në

fshat. “Me këto projekte, do t’ia ndryshojmë pamjen e Bellanicës, për të mirë”, tha Morina.

Më pas, drejtori për buxhet dhe financa, Vesel Krasniqi, i njoftoi me procesin e hartimit të buxhetit komunal. “Ne jemi të obliguar ti mbajmë vetëm dy dëgjime publike, por ne si qeveri komunale, tash e tri vite, takohemi me banorët në të gjitha fshatrat dhe përmes kërkesave dhe nevojave që paraqesin banorët, e bëjmë planifikimin e prioriteteve për investime kapitale”, tha Krasniqi. Drejtori Krasniqi, tha se “përkundër buxhetit të vogël, po mundohemi që në çdo vit, në çdo fshat të bëjmë së paku një investim”. Ai po ashtu tha se orientim dhe prioritet është zhvillimi i bujqësisë, dhe çdo projekt në bujqësi, që gjeneron vende pune, komuna do ta përkrahë, pasi në kushtet tona, bujqësia është orientimi më i mirë për zhvillim dhe hapje të vendeve të punës.

Kryetari i fshatit Isuf Sertolli dhe drejtori komunal i arsimit, Avdi Morina, i njoftuan banorët, se përmes përkrahjes së komunës, shkolla e Bellanicës, është shkolla e parë e digjitalizuar, ku nxënësit do të kenë mundësi të mësojnë edhe përmes monitorëve, kurse për këtë lloj mësimi është trajnuar edhe stafi i kësaj shkolle.

Kurse sa përket kërkesave të banorëve, përveç projekteve aktuale, ata kërkuan fushën sportive, ndriçimin në fshat, pastaj trotuarin për një pjesë të fshatit, hapjen e kanalit për shkarkimin e ujërave atmosferik, në mënyrë që të mos preken nga vërshimet e mundshme, sikur në janar të këtij viti, dhe ndërtimi i kanalizimit nga shkolla deri në fund të fshatit, si dhe riparimi i dëmtimeve në kanalizimin aktual. Këto kërkesa kishin edhe mbështetjen e anëtares së Kuvendit të Komunës, Behije Sertolli nga Bellanica, e cila tha se do angazhohet që këto projekte të hyjnë në prioritetet komunale.



Komuna përkrahë bujqit malishevas, me shtalla e motokultivator

Malishevë, 19 gusht



Në kuadër të programit komunal për mbështetje në zhvillimin e bujqësisë, dhe sot, Komuna e Malishevës, ka filluar ndërtimin e dhjetë shtallave për blegtorë dhe dhënie të pesëdhjetë motokultivatorëve, për punimin e tokës, ndërsa mbështetja për buqit malishevas, do të vazhdojë edhe në vazhdim të këtij viti dhe gjithashtu edhe në vitin 2017, do të jetë prioritet i veçantë për Komunën e Malishevës.

“Në kuadër të programit komunal për zhvillimin e bujqësisë, ne po mundohemi ti përkrahim buqit në punimin e tokës dhe rritjen e kapaciteteve të shtallave, pasi bujqësia është dega më e fuqishme e zhvillimit ekonomik në kushtet tona”, tha nënkryetari i Komunës së Malishevës, Rexhep Mazreku. “Përmes këtyre investimeve, përveç furnizimit e tregut me produkte vendore, ne synojmë edhe krijimin e vendeve të reja të punës”, tha Mazreku.

Përndryshe, Komuna e Malishevës, në bashkëfinancim ka filluar ndërtimin e dhjetë shtallave për fermerë, projekt i cili do të vazhdojë edhe me furnizimin me lopë qumështore. Ky projekt pritet të kushtojë afro 200 mijë euro.

Po ashtu me bashkëfinancim, sot ka filluar edhe ndarja e motokultivatorëve për pesëdhjetë buq të Komunës së Malishevës, ku vlera e këtij projekti është 17 mijë euro.



KPF dha gjashtë rekomandime për mbledhjen e ardhshme të kuvendit

Malishevë, 19 gusht

Komiteti për Politikë dhe Financa (KPF), i drejtuar nga kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Malishevës, Aziz Thaçi, ka mbajtur sot mbledhjen e rregullt të këtij komiteti, ku janë trajtuar një varg çështjesh, ndërsa anëtarët e komitetit, i kanë dhënë gjashtë rekomandime për mbledhjen e ardhshme të Kuvendit të Komunës.

Fillimisht, para anëtarëve të KPF-së, drejtori për buxhet dhe financa, Vesel Krasniqi, e ka prezantuar raportin gjashtëmujorë të të hyrave dhe shpenzimeve të buxhetit komunal, ku sipas tij, nga 12.5 milion sa është buxheti për këtë vit, janë alokuar 59.61 përqind e buxhetit, ndërsa marrë në total, është shpenzuar 46 përqind e buxhetit në gjashtë muajt e parë të këtij viti. Po ashtu, krahasuar me vitet paraprake, ka rritje të të hyrave vetanake. Pas kësaj paraqitje, anëtarët e KPF-së, e kanë rekomanduar për shqyrtim në mbledhjen e ardhshme të Kuvendit të Komunës.

Për mbledhjen e ardhshme të Kuvendit të Komunës së Malishevës, KPF ka rekomanduar për shqyrtim edhe raportin për gjashtë muajt e parë të këtij vitit, të njësisë së prokurimit publik, pastaj me kërkesë të Komisionit të Aksionarëve, edhe raportet e njësisë së “Hidroregjionit”, “Ekoregjionit” dhe raportin e Stacionit të Autobusëve në Malishevë.

Me kërkesën e Drejtorisë së Urbanizimit, KPF rekomandoi edhe hapjen formale të shqyrtimit publik të Planit Zhvillimor Komunal (PZHK).

Transiti, një shkollë dhe shtrati i lumit, nevoja kryesore për Malishevën

Malishevë, 20 gusht

Drejtorja për Buxhet dhe Financa në Komunën e Malishevës, ka vazhduar mbrëmë (e premte) me mbajtjen e dëgjimeve publike, në kuadër të hartimit të projekt buxhetit 2017-2019. Mbrëmë është mbajtur takimi me banorët e qytetit të Malishevës, ku u debatua për nevojat e qytetit, përkatësisht investimet që ka nevojë të bëhen në Malishevë.

Fillimisht nënkryetari i Komunës së Malishevës, Rexhep Mazreku, i njoftoi të pranishmit për qëllimin e takimit dhe i përmendi disa nga investimet e komunës, gjatë këtyre dy viteve dhe angazhimet tjera të komunës, në investimet kapitale në Malishevë. Ndërsa drejtori i urbanizim, Ahmet Morina, i njoftoi me projektet që janë realizuar, apo janë në realizimin e sipër në Malishevës, ndërsa tha se në disa nga projektet, ka probleme në realizim për shkak të pengesave



nga pronarët e ndryshëm, siç është rrethoja e QKMF-së, kanalizimet e ujërave atmosferike në dy raste, e të tjera.



Për formën e përgatitjes së buxhetit, i njoftoi drejtori për buxhet, Vesel Krasniqi. “Këto investime, me këto mjete që kemi, do ti investojmë së bashku, ashtu siç keni nevojë ju. Në dy vitet e kaluara kemi qenë më shumë të fokusuar në fshatrat e largëta, aty ku kanë munguar investimet, ndërsa këtë vit dhe në vitin 2017, krahas përkrahjes së bujqësisë, prioritet do të jetë qytetit, ku i kemi menduar disa investime, por ato do ti bëjmë së bashku, sipas nevojave që ju mendoni se janë më me rëndësi”, tha drejtori Krasniqi.

Gjatë debatit, banorët pjesëmarrës në këtë takim, si nevoja më me prioritet i paraqitën, rregullimin e rrugës tranzite në qytet, ndërtimin e një shkolle fillore, ndriçimi, trotuar, disa rrugica, rregullimi i infrastrukturës në lagjen e re (në Golesh), rregullimi dhe drejtim i shtratit të lumit Mirusha, shtigje për ecje, ujësjellësi dhe rruga në një pjesë të lagjes së Gurit.

Janë bërë të gjitha përgatitjet për fillimin e vitit shkollor 2016-2017

Malishevë, 22 gusht

Përgatitjet për fillimin e vitit të ri shkollor kanë përfunduar dhe çdo është gati për hapjen e shkollave më 1 shtator. Kështu është e bërë e ditur në mbledhjen e rregullt të Këshillit të Drejtorëve, të udhëhequr nga nënkryetari i Komunës së Malishevës, Rexhep Mazreku, e ku janë diskutuar edhe çështje tjera që kanë të bëjnë me aktivitetet e përditshme të drejtorive komunale.

Drejtori i Drejtorisë për Arsim dhe Edukim, Avdi Morina, ka njoftuar se drejtorja, i ka bërë të gjitha përgatitjet për 1 shtator, dhe në bazë të të dhënave nga drejtoritë e shkollave, janë bërë të gjitha përgatitjet për fillimin e vitit të ri shkollor 2016-2017. Drejtorja Morina, po ashtu ka bërë të ditur, se në shkollimin e mesëm, kanë mbetur pa e regjistruar rreth 300 nxënës, të cilët do të kenë mundësinë të regjistrohen duke filluar nga sot, për tri ditë me radhë (22,23 dhe 24 gusht 2016), të cilët mund ti paraqesin dokumentet për regjistrim në klasën e dhjetë.

Pa fillimit të vitit shkollorë, në Malishevë do organizohet një shkollë verore, që do të zgjatë dy ditë. Kështu ka njoftuar drejtoresha për kulturë, rini dhe sport, Blerta Krasniqi. Ajo ka bërë të ditur se do të organizohet një shkolle verore, dy ditore, në Qendrën Rinore në Malishevë dhe në Qendrën e Kompetencës “Kujtim Krasniqi” në Malishevë.



Sa i përket aktiviteteve tjera, u bë e ditur se janë duke vazhduar një varg projektesh, si në infrastrukturën e përgjithshme, ashtu edhe në sektorin e bujqësisë, ndërsa këtë vit, nuk janë shënuar shumë raste të aksidenteve me zjarre apo aksidenteve në trafik, dhe rrjedhimisht, ka pasur më pak ndërhyrje nga ana e shërbimeve të zjarrfikësve dhe shpëtimit, e po ashtu, u bë e ditur se situata me ethe hemorragjike është shumë stabile dhe rastet e thumbimeve nga rriqrat janë shumë të rralla.

Ndërsa, sa i përket procesit të hartimit të buxhetit komunal për vitet 2017-2019, drejtori për buxhet Vesel Krasniqi, tha se” janë duke vazhduar takimet dhe konsultimet me publikun, kurse në javën e ardhshme është paraparë edhe një tryezë, me përfaqësues të komiteteve, anëtarëve të asamblesë, shoqërisë civile dhe drejtorive komunale, me qëllim të hartimit sa më të mirë të projekt buxhetit, e në veçanti të orientimit në projektet kapitale”.

Të rinjtë e Malishevës, në fushatë vetëdijesimi për kujdes në vozitje

Malishevë, 23 gusht



Organizuar nga Kuvendi i të Rinjve të Malishevës dhe në bashkëpunim me Policinë e Kosovës në Malishevë, të rinjtë malishevas, po zhvillojnë një fushatë vetëdijesuese për kujdes në trafik, përkatësisht për kujdes gjatë vozitjes, me moton “Kujdes-Shpejtësia vret”. Gjatë kësaj fushate, të rinjtë, kanë shpërndarë edhe fletushka, përmes së cilave ju bëhet thirrje vozitësve për kujdes të shtuar gjatë vozitjes.

Sipas kryetarit të Kuvendit të Rinjve të Malishevës, Lulzim Buzhala, “kjo fushatë është mirëpritur nga ana e vozitësve dhe nga qytetarët, pasi numri i madh i veturave, sidomos gjatë verës, shton edhe rrezikun në trafik, ndërsa qytetarët dhe vozitësit, janë shprehur të kënaqur me veprimin e të rinjve, për t’iu bërë thirrje vozitësve për kujdes gjatë vozitjes”.

Po ashtu Buzhala, ka bërë të ditur, se këtë projekt e ka ndihmuar Komuna e Malishevës dhe Policia e Kosovës.



Këta të rinj vullnetar gjatë ditës së sotme, në bashkëpunim me policinë, i kanë shpërndarë këto fletushka dhe kanë biseduar me vozitësit, duke ju sqaruar rrezikun e mos përshtatjes së shpejtësisë në trafik dhe duke ju dhënë këshilla profesionale nga ana e zyrtarëve të Policisë së Kosovës.

Filloi rregullimi i të gjitha rrugëve në Dragobil

Malishevë, 24 gusht



Në kuadër të implementimit të projekteve kapitale dhe rregullimit të infrastrukturës rrugore, në të gjitha vendbanimet e Komunës së Malishevës, sot kanë filluar punimet në rregullimin e të gjitha rrugëve dhe rrugicave në fshatin Dragobil. Fillimin e punimeve e kanë parë nga afër edhe nënkryetari i Komunës së Malishevës, Rexhep Mazreku, dhe drejtori i urbanizimit Ahmet Morina, të cilët edhe i kanë uruar banorët për

rregullimin e rrugëve.

“I uroj të gjithë banorët e Dragobilit, për rregullimin e rrugëve në fshat”, tha nënkryetari Mazreku, sipas të cilit, këto investime, janë duke u bërë në kuadër të përpjekjeve të komunës, për rregullimin e infrastrukturës së përgjithshme, në të gjitha vendbanimet.

Ndërsa drejtori i urbanizimit Ahmet Morina, tha se janë duke u rregulluar të gjitha rrugët dhe rrugicat në Dragobil. Drejtori Morina, bëri të ditur, se krahas rrugëve dhe rrugicave brenda fshatit, do të rregullohet edhe rruga që lidhë një pjesë të lagjes Pallanka, me qytetin e Malishevës. “Sot ka filluar rrafshimi i rrugëve dhe përgatitja për asfaltimin e këtyre rrugëve dhe besoj brenda pak ditëve, të gjitha rrugët në Dragobil, përfshi edhe lagjen Pallanka, do të asfaltohen dhe përmes kësaj, banorët e Dragobilit, do të kenë lehtësi në lëvizjen e tyre, pasi infrastruktura rrugore, në tërësi po rregullohet”.



Filloi shkolla rinore verore në Malishevë

Malishevë, 24 gusht



Sot në Malishevë, ka filluar shkolla rinore verore, e cila do të zgjasë dy ditë, e në të cilën po marrin pjesë rreth 45 të rinj, anëtar të organizatave rinore, si Qendre Rinore, Këshilli Veprimit Rinor Lokal dhe Kuvendi i të Rinjve të Malishevës. Gjatë këtyre dy ditëve, pjesëmarrësit e kësaj shkolle, do të kenë mundësi të dëgjojnë tema nga të gjitha fushat e jetës dhe të zhvillojnë debate të ndryshme, do të ketë shfaqje të

filmave nga DOKUFEST-i, pastaj do të organizojnë lojëra dhe shëtitje.

Në hapjen e kësaj shkolle dy ditore, morën pjesë edhe nënkryetari i Malishevës, Rexhep Mazreku, drejtoresha për kulturë, rini dhe sport, Blerta Krasniqi, zyrtarë policorë dhe përfaqësuesit e rinisë në Malishevë. me këtë rast, nënkryetari Mazreku, i ka përshëndetur të rinjtë pjesëmarrës të kësaj shkolle, duke ju dëshiruar sukses, si dhe tha se “Komuna e Malishevës, do ti përkrahë gjithmonë aktivitetet rinore, në veçanti aktivitetet me karakter arsimor dhe edukativ”.

Po ashtu, edhe drejtoresha Krasniqi, i ka uruar pjesëmarrësit e kësaj shkolle dyditore. “Ky është viti i tretë me radhë që organizohet kjo formë e shkollës verore, ku ju të rinj, keni mundësi të mësoni dhe të merrni aftësi, përmes ligjëratave që mbahen gjatë këtyre dy ditëve”, tha drejtoresha Krasniqi.

Në Kleçkë, ekspozohet vetura e Komandant Kumanovës

Malishevë/Kleçkë, 25 gusht

Sot, në kompleksin e varrezave të dëshmorëve të Brigadës 121 të UÇK-së, “Ismet Jashari-Kumanova”, në Kleçkë, është ekspozuar vetura e Komandant Kumanovës. Ky ekspozim i veturës, është përcjellë me homazhe në varrezat e dëshmorëve të kombit, si dhe me përrurimin e librit “Në çdo lis një sy shqiponje”, kushtuar togut të artillerisë së Brigadës 121. Këto aktivitete janë mbajtur në kuadër të shënimit të Ditës së Brigadës 121, e cila mbante emrin e Komandant



Kumanovës, i cili bashkë me luftëtarë të tjerë, ranë heroikisht më 25 gusht të vitit 1998, në vargmalet e Berishës.



Fillimisht, janë bërë homazhe në varrezat e dëshmorëve, në kompleksin memorial, kushtuar dëshmorëve të Brigadës 121, ku morën pjesë, deputeti dhe kryetari i “NISMA për Kosovës”, Fatmir Limaj, nënkryetari i Komunës së Malishevës, Rexhep Mazreku, deputet tjerë të Kuvendit të Kosovës, zyrtarë komunal të Malishevës, familjarë të dëshmorëve, veteran të luftës, dhe qytetarë të shumtë.

Më pas, në këtë kompleks memorial, është ekspozuar vetura e Komandant Kumanovës, të cilën e kishte përdorur komandanti gjatë luftës, dhe e cila është një “artefakt” i luftës dhe dëshmi e luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Përrurimin e vendit ku është ekspozuar vetura e Komandant Kumanovës, e bënë Fatmir Limaj, ish anëtar i SHP të UÇK-së, Nderim Jashari, nip i komandant Kumanovës, Metush Kryeziu, kryetari i ShVL të UÇK-së në Malishevë dhe nënkryetari i Komunës së Malishevës, Rexhep Mazreku.

Në këtë ditë të shënuar për Brigadën 121, u bë edhe promovimi i librit monografi “Në çdo lis një sy shqiptonje” me autor Arsim Krasniqi, Nasuf Gashi dhe Hasan Maksuti, kushtuar togut të artilerisë së Brigadës 121 “Kumanova”. “Ky libër është një përjetësim i luftës çlirimtare”, tha prof.Dr. Ibrahim Gashi, historian dhe recensues i librit. Gashi, e quajti përgjegjësi të madhe, përjetësimin e një lufte, ose të një pjese të luftës, por autorët, sipas tij, e kanë dokumentuar mirë këtë libër, dhe këtë përgjegjësi, pasi është libër i kompletuar në aspektin metodologjik dhe me fakte. Ndërsa për aspektin luftarak të artilerisë, foli major Petrit Rrahmani, dhe për rëndësinë e këtij togu dhe për rolin që ka pasur gjatë luftës, foli Mr.Haxhi Shala-komandant i Brigadës 121 “Ismet Jashari-Kumanova”.

KK i Malishevë, shqyrtoi raportin gjashtë mujor financiar

Malishevë, 26 gusht



Kuvendi i Komunës së Malishevës, drejtuar nga kryesuesi i saj, Aziz Thaçi, ka mbajtur sot mbledhjen e tetë të rregullt për këtë vit. Në këtë mbledhje, Kuvendi i Komunës, ka shqyrtuar raportin financiar janar-qershor 2016, si dhe i ka dhënë dritën e gjelbër, daljes në diskutim publik të Planit Zhvillimor Komunal.



Raportin financiar gjashtë mujorë, për të hyrat dhe shpenzimet e buxhetit komunal, para anëtarëve të kuvendit, e ka prezantuar drejtori për buxhet, Vesel Krasniqi, sipas të cilit, ka rritje të vogël të të hyrave vetanake, në raport me vitin paraprak, ndërsa brenda gjashtë muajve, është

shpenzuar rreth 47 për qind e buxhetit. Krasniqi, është përgjigjur dhe ka dhënë sqarimet në pyetjet e anëtarëve të kuvendit.

Po ashtu, KK i Malishevës, ka miratuar kërkesën e Drejtorisë së Urbanizimit, për iniciimin e procedurave të dëgjimit publik të Planit Zhvillimor Komunal. Arsyeshmërinë e kësaj kërkesë e paraqiti drejtori i urbanizimit, Ahmet Morina, i cili tha se ky plan zhvillimor, do të jetë i hapur për diskutim publik, për një muaj, prej ku do të merren sugjerimet e qytetarëve, shoqërisë civile, përfaqësuesve politik dhe ekspertëve të fushave të caktuara, me qëllim të gjithëpërfshirjes në hartimin e këtij plani.

KK i Malishevës, e ka shtyrë për mbledhjen e ardhshme, raportin e zyrës së prokurimit publik, për periudhën nga janari i këtij viti, e deri më tani, pasi personi përgjegjës, ishte në udhëtim jashtë vendi.

Komuna nderon humanistin Bashkim Shala

Malishevë, 29 gusht

Kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, sot ka ndarë një mirënjohje për humanistin dhe bashkatdhetarin Bashkim Ferat Shala nga Guncati. Këtë mirënjohje, kryetari Begaj, e ka ndarë për humanistin Shala, për shkak të aktiviteteve të tij humane, përkatësisht për blerjen e 75 karrocave për personat me aftësi të kufizuara në Komunën e Malishevës.



Muaj më parë, Bashkim Ferat Shala, që jeton dhe punon në Zvicër, i ka dhënë Qendrës së Rehabilitimit – HANDIKOS në Malishevë, një donacion prej 75 karrocave për nevojat e kësaj qendre, përkatësisht për personat të cilët kanë nevojë të lëvizin me karrocë.

Po ashtu, humanisti Shala, kohë më parë, ka furnizuar me kabinet të informatikës, edhe shkollën në fshatin Guncat. Të gjitha

këto donacione nga buxheti i tij personal.

Për këtë qëllim, sot, kryetari i Komunës së Malishevës, e ka nderuar me mirënjohje, humanistin Shala, i cili edhe në të kaluarën ka bërë vepra të tilla humane, në dobi të shoqërisë dhe komuniteteve të caktuara.

Më 1 shtator hapet shkolla në Gurishtë

Malishevë, 29 gusht

Sot në mbledhjen e rregullt të Këshillit të Drejtorëve, që drejtohet nga Kryetari i Komunës, Ragip Begaj, u bë e ditur se me një shtator do të bëhet hapja zyrtare e objektit të ri të shkollës në fshatin Gurishtë, e po ashtu, pritet që me një shtator të hapet e aneksi i shkollës në Mirushë. Sipas drejtorit të arsimit Avdi Morina, këto dy shkolla, do të mësojnë në një ndërrim dhe me këto, numri i shkollave në territorin e Komunës së Malishevës, që mësojnë në një ndërrim, shkon në dymbëdhjetë shkolla.

Në mbledhjen e sotshme, edhe drejtori për shëndetësi Hajdin Berisha, ka bërë të ditur se, kanë marrë vendim për uljen e gatishmërisë lidhur me ethet hemorragjike krime kongo (EHKK), përkatësisht, kanë zvogëluar orarin e punës së laboratorit në QKMF, pasi rastet e thumbimeve nga rriqrat, kanë rënë dukshëm, por pavarësisht kësaj, kujdesi do të vazhdoj deri më 30 shtator, kur edhe llogaritet se përfundimisht largohet rreziku nga EHKK. Me këtë rast, drejtori Berisha, ka konfirmuar se në këtë vit, në territorin e Komunës së Malishevës, nuk është regjistruar asnjë rast i infeksionit me virusin e EHKK.

Sa i përket sëmundjeve, edhe drejtorja e inspektoratit, përkatësisht shefi i drejtorisë Bardhyl Buçaj, gjatë raportit të tij, ka bërë të ditur se inspektorët komunal, janë duke i inspektuar stallat në tërë territorin e Komunës së Malishevës, lidhur me sëmundjen gungore të kafshëve, por deri më tani nuk kanë hasur në asnjë rast të kafshëve të infektuara.



Gjatë raportimeve të drejtorëve, u bë e ditur, se po vazhdojnë punimet në realizimin e disa projekteve kapitale, kryesisht në infrastrukturë. Drejtori i urbanizmit, Ahmet Morina, duke njoftuar për projektet, tha se gjatë vikendit, ka filluar edhe rregullimi i rrugës për nxënësit e lagjes Dobruna, në Llazicë, në mënyrë që fëmijët e kësaj lagjeje, përkatësisht për rreth 150 nxënës, do të rregullohet rruga nga lagja e tyre, deri në shkollën e fshatit.

Edhe drejtori për buxhet dhe financa, Vesel Krasniqi, ka njoftuar se janë në proces të hartimit të qarkores së dytë buxhetore, ku për këtë qëllim krahas takimeve nëpër fshatra, më 31 gusht, do të mbahet një tryezë, e organizuar nga OSBE dhe me 2 shtator, do të mbahet dëgjimi i fundit publik, me qytetarë dhe me kryetarë të fshatrave.

KN “Besa” krenaria e Malishevës

Malishevë, 30 gusht



Kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, drejtoresha për kulturë, rini dhe sport, Blerta Krasniqi dhe drejtori i arsimit, Avdi Morina, kanë pritur sot kampionët e shumëfishtë të Kosovës, në not, KN “Besa”, të cilët i kanë uruar me rastin e triumfit në Kupën e Kosovës në Not, ku klubi mori katër nga pesë kupat e mundshme, duke u shpallur kështu edhe fitues të Kupës së Kosovës.

Kryetari Begaj, fillimisht i ka uruar për suksesin e treguar në vazhdimësi gjatë këtij viti dhe viteve të mëparshme. “Ju na bëni të ndihemi krenarë me juve dhe ju jeni krenaria e Malishevës”, ju ka thënë kryetari Begaj, notarëve të klubit të notit “BESA”.

Trajneri i ekipit, Adrian Telaku, e ka falënderuar kryetarin Begaj dhe Komunën e Malishevës, për përkrahjen e dhënë në vazhdimësi, si dhe ka treguar edhe për sfidat e klubit, deri në arritjen e suksesit. Sipas tij, me gjithë kohën e shkurtë të ushtrimeve, pasi nuk disponojnë pishinë të mbyllur, klubi ka arritur suksese të jashtëzakonshme, duke a dalë fitues në të gjitha garat, sikur edhe në Kupën e Kosovës, ku triumfuan bindshëm.



KN “Besa”, dje në garat e Kupës së Kosovës, ka dalë fitues në kategorinë e juniorëve, kadetëve, pionierëve dhe fillestarëve për meshkuj. Gjatë këtij viti, KN “Besa”, ishte kampion i Kosovës, në kategorinë e juniorëve, pastaj, fitues i garës tradicionale “Esmir Shala”, fitues i garës “Kupa e Bifurkacionit” dhe tani edhe fitues i katër kategorive në garat e Kupës së Kosovës në not, duke bërë klubin më të suksesshëm të notit në vend dhe natyrisht klubin më të suksesshëm nga Malisheva. Po ashtu rezultatet e mira, nuk kanë munguar as në garat tjera në nivel vendi dhe në nivel kombëtar.

Ambienti, bujqësia, transiti dhe shtrati i lumit, prioritet i Malishevës për vitin 2017

Malishevë, 31 gusht



Sot në Malishevë, organizuar nga OSBE misioni në Kosovës dhe Drejtoria Komunale, u mbajt një punëtori, lidhur me zhvillimin e buxhetit komunal, për vitin 2017. Krahas kryetarit dhe qeverisë komunale, në këtë punëtori morën pjesë edhe përfaqësues të shoqërisë civile, pastaj anëtarë të Kuvendit të Komunës dhe anëtarë të Komitetit për Politikë dhe Financa.

Kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, duke folur në këtë punëtori, tha se “është shumë e rëndësishme që konsultimet për buxhetin të mbahen edhe në këtë formë”. “Ne kemi një strategji të hartimit të buxhetit dhe ajo strategji është konsultimi me qytetarë dhe buxheti, përkatësisht investimet kapitale, orientohen sipas nevojave që kanë qytetarët”, tha Begaj, sipas të cilit, ambienti, bujqësia, arsimiti, transiti dhe shtrati i lumit, do të jenë prioritetet për vitin e ardhshëm.

“Procesi i zhvillimit të buxhetit është shumë i rëndësishëm për komunën tuaj, pasi është mjet i rëndësishëm për caktimin e prioritetëve dhe i planifikimit”, tha Yusuke Hara, zyrtar i OSBE-së.

Më pas, drejtori i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, Vesel Krasniqi, e bëri një prezantim të hollësishëm të procesit të hartimit të buxhetit komunal, duke filluar nga qarkorja e parë buxhetore, pastaj debatet me qytetarë, tryezat apo punëtoritë si kjo e sotmja, e deri në hartimin final të projekt buxhetit. “Këtë vit, kemi arritur që kërkesat e dy sektoreve të fusim si kode



buxhetore, atë për çështje gjinore dhe për rini”, tha Krasniqi, ndërsa sipas tij, buxheti për vitin për vitin 2017 do të jetë 12 866 848 euro, i ndarë në pesë kategori buxhetore, kurse për investime kapitale, do të jenë rreth katër milion. Po ashtu Krasniqi, bëri të ditur, se Malishevës, buxheti i ndahet për 54 613 banorë.

Më pas edhe drejtorët e drejtorive veç e veç, e kanë bërë prezantimin e drejtorive të tyre dhe prioriteteve për vitin 2017, kurse në fund pjesëmarrësit në këtë punëtori i kanë dhënë opinionet e tyre për buxhetin, si përfaqësuesi të kuvendit, ashtu edhe përfaqësuesit e organizatave jo qeveritare në Malishevë.